



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/ \_\_\_\_\_

Më: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 19.02.21

PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 11/210

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. e Vendimit të DKAE-së me Nr;11/199 dt, 16.02.2021. Drejtoria për Arsim dhe Edukim rishpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2020

Nr	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" Habib Berisha" në Gurbardh	Mësimdhënës i lëndës së gjuhës shqipe	Me kohë të caktuar deri sa të kthehet punëtori prej pushimit të lehonisë	1	20

### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- certifikata e lindjes

### II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të lëndës së gjuhës shqipe kërkohet kualifikimet: Fakulteti i Edukimit-Niveli master arsimor- ( 300 ECTS); Sistemi katërvjeçar; Bachelor(katërvjeçar 240 ECTS). ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përparë.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në ueb- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

#### **Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **19.02.2021** më datën: **05.03.2021**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.